



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2025

VENDIM
Nr. 650, datë 23.09.2025

**PËR PËRFUNDIMIT PARA AFATIT TË TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM ME
PËLQIM PËR GJYQTARIN Z. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 dhe 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 46, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe bazuar në Vendimin të tij nr. 588 datë 09.09.2025, “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit z. {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”, në kushtet kur verifikohet që gjyqtari i transferuar me pëlqim, të jetë transferuar nëpërmjet lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Përfundimin para afatit të transferimit të përkohshëm me pëlqim, për gjyqtarin z. {...}.
2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 24.09.2025.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR